



Republika e Kosovës Republika  
Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

Kuvendi Komunal

01 Nr. 06-368/1

Dt. 21.03.2012

**D r a g a s h**

Në mbështetje të nenit 12 par.2 lidhur me nenin 58 shkronja (h të Ligjit për Vetëqeverisen Lokale Nr.03.L-040 ("G.Z. e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), si dhe në mbështetje të dispozitave të nenit 4. par.2, 8, 15, dhe 16 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Palujtëshme, konform nenit 32.2.e Statutit të Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008 ,Kuvendi i Komunës së Dragashit në mbledhjen e mbajtur 21.03.2012, miraton këtë:

## V e n d i m

**PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM** – për vendosjen e tubacioneve të ujërave në një gjërësi prej 3.5 metrave nga vepra e marrjes e deri te hidrocentralet dhe për disa hidrocentrale që kërkojnë dalje në rrugë, mbi ngastrat kadastrale: **Brod, Dikancë, Mlik, Kukalane, Vraniç, Krushevë, Restelicë dhe Glloboqicë.**

Neni 1.

Me këtë Vendim duhet të bëhet shpronësimi i pjesëve të ngastrave kadastrale për zonat kadastrale : **Brod, Dikancë, Mlik, Kukalane, Vraniç, Krushevë, Restelicë dhe Glloboqicë.** nëpër të cilat do të kalojnë tubacionet e ujërave për hidrocentralet: **Brod 1, Brod 2, Brod 3 si dhe Restelica 1, Restelica 2, dhe Restelica 3.**

Neni 2.

Ngastrat që duhet shpronësuar janë: 1360,1339,519,520,545,546,553,556,555,1340 dhe 1337 zona kadastrale Brod, 1226, 1229/1, 1351, 1349, 1477, 1476, 1226, 1216, 1217, 1149, 1148, 761, zona kadastrale Mlike, 353, 354, 355, 356, 357, 358, 15, 16, 17, 1, 2, 3, 4.10, 5, 19, 20, 21, 22, zona kadastrale Kukalane, 257, 258, 259, 260, 265, 266, 267, 263/1, 263/2, 277/1, 277/2, 278, 279/1, 279/2, 304, 305 zona kadastrale Vraniç, 1391, 1595, 1739 zona kadastrale Restelicë, 714, 942/1, 680, 681, 709, 1212, 939, 385 zona kadastrale Krushevë, si dhe 2283/1, 1205, 1206, 1210/1, 1210/2 zona kadastrale Glloboqicë.

Neni 3.

Kompenzimin për shpronësimin e të gjitha ngastravë kadastrale nëpër të cilat kalojnë tubacionet e ujërave për hidrocentralet dhe dëmet e shkaktuara gjatë punimeve do të bëhen nga subjekti kërkuesi cili paraprakisht ka marr Vendimin preliminar nga Zyra e Rregullatorit te Energjisë më 10.02.2012 (kodi i ZRE-së:V-395-2012).

Neni 4.

Ngastrat kadastrale të cilat janë objekt i shpronësimit janë paraqitur në nenin 2 të këtij Vendimi, si dhe ne bazë të projektit të paraqitur nga subjekti kërkues i shpronësimit, në mënyrë detale në Vendimin preliminar dhe atë prfundimtar.

Neni 5.

Për zbatim të këtij Vendimi , do të kujdeset Drejtoria për Kadaster , Pronë dhe Gjeodezi i Komunës së Dragashit.

Neni 6.

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit në Kuvendin Komunal të Dragashit.

Kuvendi Komunal Dragash  
Kryesuesi  
*Lidzine Rifaj*